


**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Sun Petroleum Albania SHPK**



Sot, më 10/09/2013, në Tiranë, pala e mëposhtme (në vijim referuar si “**Ortaku Themelues**” apo “**Ortaku**”) pranon të ekzekutojë këtë Akt Themelimi:

- **Dory Grossman**, shtetas izraelit, lindur më 12.10.1979 në Israel, mbajtës i Pashaportës Nr. 20350332, rezident në adresën: 10 Aba Even Street, Hertzelia, Izrael (në vijim referuar si “**Pala**”).

I. Themelimi

1. Ortaku Themelues deklaron themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin SUN Petroleum Albania SHPK, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“**Ligji Tregtar**”).
2. Zyra e regjistruar e shoqërisë është në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, nr. 5, Sky Tower 13/4, 1000 Tiranë, Shqipëri.
3. Shoqëria është krijuar për një afat të pacaktuar.

II. Objekti

1. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë, përfshin por nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:
 - (a) Shitje me pakicë benzinë, naftë, gaz, lubrifikantë dhe çdo produkt dhe nën-produkt të tyre;
 - (b) Hapja dhe menaxhimi i pikave të karburantit që kryejnë aktivitet shitje me pakicë në të gjithë vendin;
 - (c) Import-eksport i çdo dhe të gjithë mallrave sipas legjislacionit shqiptar;
 - (d) Hapja dhe menaxhimi i bareve, restoranteve, dyqaneve, qendra tregtare dhe biznesi të çdo lloji;
 - (e) Tregti me shumicë dhe pakicë të çdo dhe të gjithë mallrave në përputhje me legjislacionin Shqiptar;
 - (f) Ndërtim dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur, përfshirë por pa u kufizuar në import-eksport të materialeve të ndërtimit dhe pjesë;
 - (g) Dhe në përgjithësi çdo dhe të gjithë aktivitetet që lejohen dhe nuk ndalohen në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit shqiptar.
2. Me qëllim përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria gjithashtu, mund të:
 - (a) kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë;
 - (b) blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj; dhe
 - (c) kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.
3. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohet nga ligji i zbatueshëm.

DG

III. Akti i Themelimit

1. Ortaku Themelues deklaron miratimin e Aktit të Themelimit të Shoqërisë.

IV. Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë është LEKË 100,000 (njëqindmijë Lekë Shqipëtarë) i ndarë në 100 (njëqind) aksione të zakonshme me vlerë nominale LEKË 1,000 (njëmijë Lekë Shqiptare) secili. Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht është, si më poshtë:

- **Dory Grossman**, shtetas Izraelit, lindur më 12.10.1979 në Izrael, identifikuar me pashaportë nr. 20350332, rezident në adresën: 10 Aba Even Street, Hertzelia, Israel;

2. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

V. Bordi i Administratorëve

1. Shoqëria drejtohet nga Bordi i Administratorëve i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme ndërmjet ortakeve apo jashtë rradheve të tyre. Bordi i Administratorëve përbëhet nga (i) Drejtori Ekzekutiv ("DE"), dhe (ii) Drejtori Financiar ("DF"), të cilët do të nënshkruajnë bashkarisht çdo dhe të gjitha aktet e shoqërisë.
2. Anëtarët e Bordit të Administratorëve do të veprojnë bashkarisht dhe do të jenë përgjegjes për administrimin e përditshëm të Shoqërisë, sipas kufizimeve të vendosura nga Statuti, ligji i zbatueshëm dhe Asambleja e Përgjithshme.
3. Anëtarët e Bordit të Administratorëve emerohen për një afat 1 (një) vjeçar dhe mund të riemerohen. Megjithatë, Anëtarët e parë të Bordit të Administratorëve do të qëndrojnë në detyrë deri më 31.12.2013 dhe mund të riemërohen. Anëtarët e parë të Bordit të Administratorëve të Shoqërisë janë:
- **Z. Ibrahim AKTOZ**, shtetas turk, lindur në Adana (Turqi) më 2 nëntor 1971, mbajtës i Pashaportës Nr. U 06517987; dhe
- **Z. Guram GOGESHBILI**, shtetas gjeorgjan, lindur në Tbilisi (Gjeorgji) më datë 16 janar 1976, mbajtës i Pashaportës Nr 07AD60325;
4. Akte me firmën e të dy anëtarëve të Bordit të Administrimit janë detyrues për Shoqërinë sipas kufizimeve të vendosura nga Statuti, ligji i zbatueshëm apo vendimet përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme që vendos kufizime të tagrave dhe kompetencave të anëtarëve të Bordit të Administratorëve.
5. Anëtarët e Bordit të Administratorëve të Shoqërisë mund të emerojnë një perfaqësues "*ad negotia*" për kryerjen e detyrave specifike apo të kategorive të detyrave specifike sipas kufizimeve të kompetencave vendosur nga ky statut apo nga ligji.
6. Anëtarët e Bordit të Administratorëve të Shoqërisë duhet t'i raportojnë Asamblesë së Përgjithshme në çdo kohë dhe në çdo rast jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit.
7. Në rast se anëtarët e Bordit të Administratorëve nuk arrijnë të zgjidhin një çështje midis tyre kjo do t'i paraqitet për zgjidhje brenda 24 (njëzetekatër) orëve Asamblesë së Përgjithshme e cila merr vendim. Ky vendim do të jetë detyrues për anëtarët e Bordit të Administratorëve dhe ka efekte të menjëhershëm për palët e treta.

8. Bordi i Administratorëve zoteron te gjitha kompetencat ne lidhje me administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem i cili eshte i nevojshem per arrijten e objektivave te Shoqerise të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me perjashtim te kompetencave qe u rezervohen organeve te tjera te shoqerise nga ky statut apo legjislacioni ne fuqi. Anëtarët e Bordit të Administratorëve duhet të kryejnë detyrat e tyre dhe të përmbushin detyrimet e tyre me besnikëri dhe korrektësi në interesin më të mirë të Shoqërisë dhe të aksionarëve të saj dhe këto kanë përgjegjësi individuale apo solidare për çdo dhe të gjitha veprimet që mund të çënojnë interesat e Shoqërisë dhe/ose aksionarëve të saj, në mënyrë direkte apo indirekte.
9. Bordi i Administratorëve ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:
- (a) sipas kërkeses se Asamblese se Përgjithshme, te marre masa qe jane ne kompetence te kesaj te fundit, t'i rekomandoje Asamblese se Përgjithshme vendimet qe duhen marre prej saj dhe te zbatoje keto vendime;
 - (b) te therrase mbledhjen e Asamblese se Përgjithshme nese konsiderohet e nevojshme per interesat e Shoqerise;
 - (c) te sigurohet se Shoqeria respekton ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
 - (d) te shqyrtoje dhe te mbaje librat kontabel, dokumentet dhe asetet e Shoqerise;
 - (e) te siguroje se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabel te kryhet te pakten nje here ne vit nga nje ekspert kontabel i autorizuar, dhe se raporti i auditimit i eshte derguar dhe vene ne dispozicion Asamblese se Përgjithshme;
 - (f) Çdo te drejte ose detyrim tjetër te percaktuar nga ligji.
10. Bordi i Administratorëve nuk mund të ekzekutojë marrëveshje apo të lidhë kontrata për llogari të Shoqërisë që kalojnë vlerën prej EUR 200,000.00 (dyqindmijë euro) dhe nuk mund të kryejë pagesa në favor të palëve të treta mbi vlerën EUR 200,000.00 (dyqindmijë euro) për të cilat duhet miratimi i Asamblesë së Përgjithshme.
11. Kompetencat dhe detyrat e anëtarëve të Bordit të Administratorëve vendosen dhe ndryshohen rregullisht me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

VII. Eksperti/t Kontabël të Autorizuar

1. Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një apo më shumë ekspertë kontabël të autorizuar të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një vit financiar. Ekspertët e parë kontabël të Shoqërisë për vitin financiar 2013 janë Deloitte Albania Sh.p.k.

Akti i Themelimit është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën angleze me vlerë të njëjtë ligjore. Për çdo konflikt që lind në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Akti Themelimi, versioni në anglisht do të jetë versioni i vetëm detyrues për palët dhe me efekte ligjore. Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshime.

Ortaku Themelues


Dory Grossman

DG

Përkthues:
Kozeta Gjeç

**ACT OF INCORPORATION
OF THE LIMITED LIABILITIES COMPANY
Sun Petroleum Albania SHPK**

Today, on the 10/09/2013, in Tirana, the following party (hereinafter referred to as the "Founding Shareholder", or the "Shareholder") agree to adopt the present Act of Incorporation, as follows:

- **Dory Grossman**, Israeli citizen, born on 12.10.1979 in Israel, identified with his passport no 20350332, with its registered address at 10 Aba Even Street, Hertzelia, Israel;

(hereinafter called as the "Party").

I. Establishment

1. The Founding Shareholders hereby declare the establishment of the Limited Liabilities Company named SUN Petroleum Albania SHPK, in accordance with the provisions of the Law No. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and Commercial Companies" (the "Company Law").
2. The registered address of the Company is at Rt. Ibrahim Rugova, no 5, Sky Tower 13/4, 1000 Tirana, Albania.
3. The Company has been established for an unlimited duration.

II. Object

1. The scope of activities of Company shall include, but not limited to, the following activities:
 - (a) Retail sale of petroleum, oil, gas, lubricants and of any product and sub-product related thereto;
 - (b) Opening and managing of gas stations with retail activity throughout the country;
 - (c) Import-export of any and all goods permitted under Albanian legislation;
 - (d) Opening and management of bar, restaurants, convenience stores, trade and business centres of any kind;
 - (e) Wholesale and retail of any and all goods, as permitted under Albanian legislation;
 - (f) Construction and any other related activity; including but not limited to import-export of construction materials, and parts;
 - (g) And in general any and all activities, which are permitted and not prohibited in the Republic of Albania, under Albanian legislation.
2. For the purpose of achieving the foregoing purposes, the Company may also:
 - (a) carry out any transaction concerning moveable or real properties, as well as any commercial, financial, renting or mortgage activity, which may be considered useful or necessary in order to achieve the Company's purpose;
 - (b) acquire, directly or indirectly, interests in other companies which have a purpose similar to the one of the Company, in Albania or abroad; and

OG

- (c) any other activity which may be considered useful or necessary in order to achieve the Company's purpose.
3. In addition, the Company may carry out any business activity, which is not prohibited under applicable law.

III. Articles of Association

1. The Founding Shareholder hereby declare the adoption of the Articles of Association of the Company.

IV. The Share Capital

1. The subscribed share capital of the Company is ALL 100,000 (one hundred thousand Albanian lek) consisting of 100 (one hundred) ordinary shares with a par value of ALL 1,000 (one thousand lek) each. The share capital is subscribed and fully paid-up by the Sole Shareholder of the Company as follows:
- **Dory Grossman**, Israeli citizen, born on 12.10.1979 in Israel, identified with his passport no 20350332, with its registered address at 10 Aba Even Street, Hertzelia, Israel;
2. Each share confers the right of one vote.

V. Board of Administrators

1. The Company is managed by a Board of Administrators, who may or may not be a shareholders of the Company, appointed by the General Meeting. The Board of Administrators is composed by (i) the Chief Executive Officer ("CEO"), and the (ii) Chief Financial Officer ("CFO"), who shall co-sign any and all company documents to be issued.
2. The Board of Administrators shall act jointly and be responsible for the Company's day-to-day affairs of the Company, subject to the limitations provided under Articles of Association, applicable law, and by the General Meeting.
3. The Board of Administrators is appointed for a term of one (1) year and can be reappointed. Provided, however, that the first The Board of Administrators is appointed until 31.12.2013 and can be reappointed.

The first members of the Board of Administrators of the Company are:

- **Mr. Ibrahim AKTOZ**, Turkish citizen, born in Adana, Turkey, on 2nd of November 1971, holder of the Passport no. U 06517987;
 - **Mr. Guram GOGESHVILI**, Georgian citizen, born in Tbilisi (Georgia) on the 16th of January 1976, holder of the Passport no. 07AD60325;
4. The Company shall be validly bound by the co-signature of the two members of the Board of Administrators, subject to the limitations provided under Articles of Association, applicable law or relevant decision of the General Meeting limiting the powers of the Board of Administrators and competencies.
5. The Board of Administrators of the Company signing jointly may appoint a representative "*ad negotia*" for the performance of specific duties or categories of duties, within the limits of the powers granted by this act or law.

6. The Board of Administrators of the Company must report to the General Meeting any time requested, and in any case, not less than 6 (six) times a year.
7. In the event of a deadlock between the members of the Board of Administrators, the issue shall be submitted within 24 (twenty four) hours to the General Meeting for a resolution. Such resolution shall be binding for the Board of Administrators, and with immediate effects for the third parties.
8. The Board of Administrators is granted with the powers concerning the ordinary and extraordinary management, which is necessary to the achievement of the Company's plan as approved by the General Meeting, except for those powers, which are reserved to other bodies by the Article of Association or applicable law. The members of the Board of Administrators shall loyally and faithfully carry out its duties and responsibilities in the best interests of the Company and its shareholders, and they shall be liable individually or jointly for any and all actions, which may damage the interests of the Company and/or its shareholders, directly and indirectly.
9. The Board of Administrators has the following powers and duties:
 - (a) on request of the General Meeting, to adopt measures which fall into the competencies of the latter, to recommend the resolutions to be adopted by the General Meeting and to execute such resolutions;
 - (b) to convene a General Meeting if it is deemed necessary for the Company's interests;
 - (c) to ensure that the Company observes the applicable law and accounting standards;
 - (d) to examine and maintain the Company's books, documents and assets;
 - (e) to ensure that the audit of the books and records is performed at least annually by the certified public accountant, and that the certified public accountant's report is addressed and made available to the General Meeting;
 - (f) any other right or duty set by law.
10. The Board of Administrators of the Company cannot enter into agreements or contracts on behalf of the Company, which exceed the value of EUR 200,000.00 (two hundred thousand euro) monthly, and it cannot carry out payments beneficiary to third parties of value over EUR 200,000.00 (two hundred thousand euro), which shall be subject to approval by the General Meeting.
11. The powers and duties of the Board of Administrators are determined and duly amended by a decision of the General Meeting.

VII. Certified Public Accountant/s

1. The internal auditing of the Company is performed by one or more certified public accountants appointed from the General Meeting for one financial year. The first certified accountants of the Company for the fiscal year 2013 are Deloitte Albania Sh.p.k.

The Act of Incorporation was drafted in 4 (four) original copies in Albanian language and 4 (four) original copies in English language, which have equal legal value. For each dispute arising in the implementation and/or interpretation of the present Act of Incorporation, the English version shall prevail and be binding. The Act of Incorporation is drafted in accordance with the Law No. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies", as amended.

Founding Shareholder

Dory Grossman

Dory Grossman

Perktheu: Kozeta Spide

Taksa e Pulfës
U PAGUA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 10550 Rep.

Nr. — Kol.


VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, ne Tirane, me date 10.09.2013, para meje JULIAN ZHELEGU, noter prane Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit:

- **Z. Dory Grossman**, shtetas Izraelit, lindur me 12.10.1979 ne Izrael, banues ne Izrael ne adresen: 10 Aba Even Street, Hertzelia, Israel, mbajtes i pasaportes me nr. 20350332, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, njohes i gjuhes angleze,

I cili, ne prani te perkthyeses se gjuhes angleze Znj. Kozeta Speci, e njohur personalisht prej meje noterit, nenshkroi me vullnet te lire e te plote dokumentin bashkangjitur ketij vertetimi, Akt Themelimi i Shoqerise «Sun Petroleum Albania» Sh.p.k., hartuar ne gjuhen shqipe e ate angleze, e une noteri vertetoi nenshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTER
JULIAN ZHELEGU



REPUBLIC OF ALBANIA
TIRANA CHAMBER OF NOTARIES

No. 10550 of Filing

No. — of Index


AUTHENTICATION OF SIGNATURE

Today in Tirana, on 10.09.2013, in front of me JULIAN ZHELEGU, notary at the Notary Chamber of Tirana, were present:

- **Mr. Dory Grossman**, Citizen of Israel, born on 12.10.1979 in Israel, resident in Israel at the address: 10 Aba Even Street, Hertzelia, Israel, holder of passport no. 20350332, major with full capacity to act, with good knowledge of English language,

Who, in presence of the interpreter of English language Mrs. Kozeta Speci, known by me the notary, that have duly undersigned the document attached to this authentication of signature, Act of Incorporation of the company «Sun Petroleum Albania» Sh.p.k., drafted in Albanian and English language, and me the notary, certify his signature according to the law.

NOTARY PUBLIC
JULIAN ZHELEGU



STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Sun Petroleum Albania SHPK”



TITULLI I
EMRI I SHOQËRISË – SELIA E REGJISTRUAR – KOHËZGJATJA

Neni 1 – Emri i Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria e emërtuar Sun Petroleum Albania SHPK (në vijim referuar si “Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar dhe e organizuar sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
- 1.2 Shoqëria ka vulën zyrtare dhe logon e saj.

Neni 2 – Selia Ligjore

- 2.1 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, no 5, Sky Tower 13/4, 1000 Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të hapë apo të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë.

Neni 3 – Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria është krijuar për një afat të pacaktuar.

TITULLI II
OBJEKTI

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Objekti i Shoqërisë, do të përfshijë, por, nuk kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:
 - (a) Shitje me pakicë benzinë, naftë, gaz, lubrifikantë dhe çdo produkt dhe nënprodukt të lidhur me to;
 - (b) Hapja dhe menaxhimi i pikave të karburantit që kryejnë aktivitet shitje me pakicë në të gjithë vendin;
 - (c) Import-eksport i çdo dhe të gjithë mallrave sipas legjislacionit Shqiptar;
 - (d) Hapja dhe menaxhimi i bareve, restoranteve, dyqaneve, qendra tregtare dhe biznesi të çdo lloji;
 - (e) Tregti me shumicë dhe pakicë të çdo dhe të gjithë mallrave në përputhje me legjislacionin Shqiptar;
 - (f) Ndërtim dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur, përfshirë por pa u kufizuar në import-eksport të materialeve të ndërtimit dhe pjesë;
 - (g) Dhe në përgjithësi çdo dhe të gjithë aktivitetet që lejohen dhe nuk ndalohen në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit Shqiptar.
- 4.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria gjithashtu, mund të:
 - (a) kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë;

- (b) blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj; dhe
- (c) kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk ndalohet nga ligji i zbatueshëm.

TITULLI III KAPITALI THEMELTAR – KUOTAT – TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 5 – Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë është LEKË 100,000 (njëqindmijë Lekë) i ndarë në 100 (njëqind) kuota të zakonshme me vlerë nominale LEKË 1,000 (njëmijë Lekë) secila. Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht është, si më poshtë:

Dory Grossman, shtetas Izraelit, lindur më 12.10.1979 në Izrael, identifikuar me pashaportë nr. 20350332, rezident në adresën: 10 Aba Even Street, Hertzelia, Israel zotëron 100 aksione të zakonshme të Shoqërisë.

5.2 Mbledhja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit aksionar me anë të kalimit në kapitalin bazë të rezervave të disponueshme dhe të fitimeve të pashpërndara, emetimit të obligacioneve të konvertueshme dhe rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.

Neni 6 – Aksionet

- 6.1 Kuotat janë të zakonshme.
- 6.2 Akti i emetimit të kuotave hartohet në çastin e emetimit fillestar të kuotave dhe ky akt përmban të dhënat dhe duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin e zbatueshëm.
- 6.3 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Neni 7 – Transferimi i Kuotave

7.1 Kuotat e Shoqërisë janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të Shoqërisë me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme. Çdo transferim tjetër apo barrë mbi kuotat duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

TITULLI IV SEKSIONI I ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8 – Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme;
- 2) Bordi i Administratorëve;
- 3) Eksperti/t Kontabël i Autorizuar.

SEKSIONI II
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme

- 9.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e cila përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme për të shprehur mendimin e tij dhe për të votuar në proporcion me kuotat që ai zotëron.
- 9.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht ortak, me prokurë me shkrim. Në çdo rast, prokura do të jepet vetëm për një mbledhje Asamble të Përgjithshme e vlefshme për thirjen e saj të parë dhe të dytë.
- 9.4 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për të votuar për një pjesë të kuotave të tij kur voton personalisht për pjesën tjetër të kuotave të tij.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend tjetër nga selia e regjistruar e shoqërisë, brënda Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.
- 9.6 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli i Administratorëve sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë apo sipas ligjit të zbatueshëm apo kur kërkohet nga një aksionar/t të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë apo nga çdo person tjetër i autorizuar sipas ligjit të zbatueshëm. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit , jo më vonë se muaji Qershor i çdo viti me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit financiar të mëparshëm.
- 9.7 Njoftimi duhet të përmbajë çështjet që do të diskutohen dhe mbi të cilat do të merret vendim, vendin, oren dhe datën e mbledhjes, procedurat e detajuara të pjesëmarrjes dhe të votimit, informacion mbi vendin dhe menyrat e marrjes së dokumentacionit dhe projekt vendimeve të Asamblese si dhe elemente të tjera të percaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar me prokurë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nëse të gjithë ortakët që përfaqësojnë tërësisht kapitalin e Shoqërisë bien dakord të zhvillojnë mbledhjen pavarësisht parregullsive në thirrjen e saj.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave në vende të ndryshme, dhe mund të zhvillohet gjithashtu me anë të telekonferencës apo videokonferencës, apo mjete të tjera elektronike të ngjashme si faks, email etj., me kusht që të gjithë të pranishmit të identifikohen dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimin dhe të jenë pjesëmarrës aktiv të tij.
- 9.11 Një vendim i Asamblese së Përgjithshme mund të merret me një Vendim Qarkullues me shkrim pa thirrur apo mbajtur një mbledhje Asambleje, me kusht që të nënshkruhet nga të gjithë ortakët.

- 9.12 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga kryetari i cili emerohet në mbledhjen e Asamblese. Nëse nuk kërkohet prania e një noteri publik, Asambleja e Përgjithshme emeron një sekretar, i cili jo domosdoshmërisht është njëri prej ortakeve.
- 9.13 Kryetari i mbledhjes ka kompetenca të plota për të kontrolluar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e ortakeve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asambletë e Përgjithshme, dhe për të përcaktuar nëse kjo e fundit është mbledhur rregullisht dhe nëse është arritur kuorumi i domosdoshëm për të marrë vendime të vlefshme. Kryetari ka gjithashtu të drejtën të drejtoje diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.
- 9.14 Asambleja e Përgjithshme do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe çdo material i shkruar që do të diskutohet në mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme do të jetë në Anglisht. Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrjes së mbledhjes do të përgatiten menjëherë pas çdo mbledhje dhe do të nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes, dhe nga noteri publik regjistruar nëse kërkohet.
- 9.15 Në rast se Shoqëria ka vetëm një ortak zotëues të të gjithë kapitalit të Shoqërisë, vendimet e marra do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë, të dhënat apo regjistrimet e të cilit nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.

Neni 10 –Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1 Vendimet e zakonshme merren me shumicën e thjeshtë të ortakeve që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të zakonshme lidhur me çështjet e mëposhtme:
- (a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - (b) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Administratorëve;
 - (c) emërimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve;
 - (d) miratimin e shpërblimeve për personat e përmendur në paragrafet (b) dhe (c) si edhe shpërblimet për pjesën tjetër të stafit dhe punojësit të Shoqërisë;
 - (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - (f) shitje apo blerje e aseteve (qoftë me blerje kapitali apo asete, bashkim apo ndryshe) në një vlerë neto që kalon 20% (njëzet për qind) të aktivitetit total të Shoqërisë në datën e fundit të pasqyrave financiare vjetore të audituara;
 - (g) marrja përsipër e detyrimeve me vlerë neto që kalon 20% të aktivitetit total të Shoqërisë në datën e fundit të pasqyrave financiare vjetore të audituara;
 - (h) riorganizimi, prishja, shndërrimi, bashkimi, shkëputja, përthithje, shpërbërja apo likuidimi i Shoqërisë apo riorganizimi i Shoqërisë në një formë tjetër ligjore.
 - (i) miratimi i pagesave në favor të palëve të treta që kalojnë EUR 4.5m, dhe miratimi i formës dhe përmbajtjes së marrëveshjeve me palë të treta me vlerë mbi Euro 4.5 milion;
 - (j) emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administratorëve në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm.
 - (k) Çdo çështje tjetër të përcaktuar nga ligji i zbatueshëm dhe nga ky Statut.
- 10.3 Në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, këto do të merren me votën pro e të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) të ortakeve që zotërojnë kapitalin e Shoqërisë.
- 10.4 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të kualifikuar për çështjet e mëposhtme:

- (a) ndryshime apo shtesa të Statutit të Shoqërisë;
 - (b) zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit apo realizimin e shperndarjes ose te emetimit te kuotave, ose çfaredolloj garancie tjeter, ose dhenien e çdo opsioni apo te drejte nenshkrimi ose konvertimin e çdo instrumenti ne kuote apo garanci
 - (c) shpërndarja e fitimeve vjetore;
 - (d) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - (e) Ndryshimet ne te drejtat qe lidhen me kuota te kategorive te ndryshme ose çdo riblerje, blerje apo çdo perfitim tjeter te Shoqerise te çdo kuote apo garancive te tjera te Shoqerise;
 - (f) ndryshim i përbërjes së Bordit të Administrimit;
 - (g) kryerjen e çdo veprimi i cili, ne menyre te arsyeshme, pritet te çoje ne likuidimin e Shoqerise;
 - (h) riorganizimin, shperndarjen, shnderrimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqerise, ose riorganizimin e Shoqerise ne nje forme tjeter;
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme dhe me vendime qarkulluese që komunikohen me postë të regjistruar apo korier si edhe me Faks të cilët duhet të nënshkruhen nga aksionari (t) apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

SEKSIONI III ADMINISTRIMI

Neni 11 –Bordi i Administratorëve

- 11.1 Shoqëria drejtohet nga Bordi i Administratorëve i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme ndermjet ortakeve apo jashte rradheve te tyre. Numri i Administratorëve mund te ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme ne perputhje me Nenin 10.4 me lart. Bordi i Administratorëve përbëhet nga (i) Drejtori Ekzekutiv (“DE”), dhe (ii) Drejtori Financiar (“DF”), të cilët do të nënshkruajnë bashkarisht çdo dhe të gjitha aktet e shoqërisë. Aktet me firmën e të dy anëtarëve të Bordit të Administratorëve përbëjnë detyrim ligjor për Shoqërinë dhe palët e treta.
- 11.2 Anëtarët e Bordit të Administratorëve do të veprojnë bashkarisht dhe do te jene pergjegjes per administrimin e perditshem te Shoqerise, sipas kufizimeve te vendosura nga Statuti, ligji i zbatueshem dhe Asambleja e Përgjithshme.
- 11.3 Anëtarët e Bordit të Administratorëve emerohen per nje afat 1 (një) vjeçar dhe mund te rimerohen. Anëtarët e parë të Bordit të Administratorëve do të qëndrojnë në detyrë deri më 31.12.2013 dhe mund të rimerohen. Anëtarët e parë të Bordit të Administratorëve janë:
- Z. Ibrahim AKTOZ**, shtetas turk, lindur në Adana, Turqi, më 2 nëntor 1971, mbajtës i pasaportës nr. U06517987;
- Z. Guram GOGESHBILI**, shtetas gjeorgjan , lindur në Tbilisi (Gjeorgji) më datë 16 Janar 1976, mbajtës i pasaportës nr. 07AD60325.
